



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
MINISTRI

Nr. 1663B/1 prot.

Tiranë, më 22.12.2025

URDHËR

Nr. 160, datë 22.12.2025

“PËR

**SHPALLJEN E PËRKTHIMIT TË NDRYSHIMEVE NË STANDARDIN
NDËRKOMBËTAR TË RAPORTIMIT FINANCIAR 19 “FILIALET PA
PËRGJEGJËSI PUBLIKE: DHËNIA E INFORMACIONEVE SHPJEGUESE”
(SNRF 19), QË NDRYSHOJNË SNRF 7, SNRF 18, SNK 7, SNK 12, SNK 21,
SNRF 5 DHE SNRF 17”**

Në mbështetje të nenit 3, pika 4 dhe pika 5, të Ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.505, datë 17.07.2019 “Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit”,

URDHËROJ:

1. Shpalljen e përkthimit të ndryshimeve në “Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar 19 “Filialet pa përgjegjësi publike: Dhënia e informacioneve shpjeguese” (SNRF 19)”, që ndryshojnë SNRF 7 “Instrumentet Financiarë: Dhënie Informacionesh Shpjeguese”, SNRF 18 “Paraqitja dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese në Pasqyrat Financiare”, SNK 7 “Pasqyra e Flukseve të Mjeteve Monetare”, SNK 12 “Tatimet mbi të Ardhurat”, SNK 21 “Efektet e Ndryshimeve në Kurset e Këmbimit të Monedhave të Huaja”, SNRF 5 “Aktivet Afatgjata të Mbajtura për Shitje dhe Operacionet jo të Vijueshme” dhe SNRF 17 “Kontratat e Sigurimit”.
2. Aplikimi i këtyre ndryshimeve ka datë efektive më 1 Janar 2027, por lejohet zbatimi më i hershëm i tyre.
3. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

MINISTRI

Petrit Malaj

